


Perandoria Otomane

Elena Marushiakova
Veselin Popov

Burimet historike për “ciganët” në perandori | “Ciganët” në regjistrat e taksave | Ligji lidhur me “ciganët” në provincën e Rumelias | “Sanxhaku i ciganëve” – romët në ushtrinë otomane | “Sanxhaku i ciganëve” – romët në shërbimet ndihmëse të ushtrisë | Regjistri i taksave i Sulltan Suleiman i Madhërishtmi | Masat kundër nomadizmit. Vendosja e “ciganëve” | Si fitonin romët për jetën e tyre | Rënia e perandorisë otomane | Statusi civil i “ciganëve”. Legjislacioni zyrtar dhe realiteti i përditshëm | Fillimi i emancipimit të romëve

➤ Romët në Ballkan nuk kishin jetuar të izoluar nga mjedisi i tyre kulturor dhe historik; përkundrazi, ata ishin një pjesë integrale e tij dhe rrjedhimisht ishin shumë të ndikuar nga njerëz të ndryshëm të Ballkanit. Një numër domethënës i romëve kishin qëndruar në Ballkan për shekuj, të tjerët kishin migruar nga atje kudo në botë në kohërat e kaluara dhe moderne, duke marrë me vete modelet dhe traditat e trashëguara kulturore të Ballkanit. Perandoria Otomane ka dominuar Ballkanin për më shumë se pesë shekuj dhe ka lënë një përshtypje të dalluar në kulturën dhe historinë e regjionit. Kështu që roli i Perandorisë Otomane është faktori kryesor në procesin e formimit dhe zhvillimit të popullit romë.



PARATHËNIE

Perandoria Otomane (1299-1922) ka pasur një ndikim të madh në drejtimin e përgjithshëm të historisë botërore si dhe në fatin e veçantë historik të një numri të njerëzve të cilët ishin pjesë e saj për periudha

më të shkurta ose më të gjata kohore. Ekspertët e romëve thonë se Ballkani është “shtëpia e dytë e romëve”, duke theksuar rolin e rëndësishëm që Ballkani ka luajtur në formësimin e historisë, kulturës dhe gjuhës së

romëve. Shumica e popullatës rome e Perandorisë Otomane ishte vendosur në Ballkan, dhe prandaj Ballkani ka një kuptim të veçantë për fatin e tyre historik, dhe për kuptimin e situatës bashkëkohore të komunitetit.

Disa nga paragrafët më të rëndësishëm të “Ligjit lidhur me Ciganët në Provincën e Rumelias”, të nxjerrë nga Sulltani Suleiman I i Madhërishtmi janë si në vijim:

1. Ciganët mysliman nga Stambolli, Edirne dhe gjetiu në Rumelia paguajnë 22 akshe për secilën shtëpi dhe secilin person të pamartuar. Ciganët e pabesë (të krishterë) paguajnë 25 akshe, ndërsa vejushat paguajnë një aksh taksë.
2. Ata paguajnë tarifën e martesës si dhe gjatë për krime dhe keq bërje sikurse pjesa tjetër e popullsisë. [...]
3. Ciganët të cilët tregojnë kokëfortësi dhe humbin nga distrikti i tyre gjyqësor, duke u fshehur në ndonjë distrikt tjetër apo në ndonjë oborr, duhet gjetur, qortuar, dënuar ashpër dhe duhet kthyer në distriktin e tyre. [...]
4. Gjatat, taksat e zakonshme dhe ndëshkimet për veprat serioze kriminale të shqiptuara ndaj Ciganëve nga sanxhaku i Ciganëve, i përkasin udhëheqësit të sanxhakut të Ciganëve. Askush nga administrata lokale ose ushtria nuk duhet të ndërhyjë. Nga kjo përjashtohen Ciganët të cilët janë të regjistruar si bataçqi në paga, çifligje, dhe toka të sulltanit.
5. Taksat e Ciganëve nga tokat feudale të lartpërmendura mbledhen nga udhëheqësi i Ciganëve. Udhëheqësi i sanxhakut të Ciganëve, udhëheqësit e regjioneve në secilën provincë, policia dhe të tjerët nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë me ta.
6. Nëse Ciganët mysliman fillojnë të bredhin me Ciganët jo-mysliman, të jetojnë dhe të përzihen me ta, ata duhet të qortohen; pasi që të ndëshkohen, Ciganët e pabesë paguajnë taksat e tyre si zakonisht.
7. Ata Ciganë që janë në posedim të një autorizimi nga sulltani duhet të paguajnë vetëm taksën e sulltanit dhe nuk paguajnë taksat mbi pronën... taksat tjera të zakonshme.”

III. 2

(e shkurtuar nga Marushiakova / Popov 2001, f.32)

BURIMET HISTORIKE PËR “CIGANËT” NË PERANDORI

Migrimi i parë i romëve në Azinë e vogël dhe Ballkan, në tokat e Perandorisë Bizantine, daton para shekullit të 14-të. Një numër i madh i romëve arritën më vonë në Ballkan në kohën e invadimeve të Otomanëve në shekullin e 14-të dhe 15-të. Ata ose merrnin pjesë direkt në invadime (kryesisht si ushtarë ndihmës ose si zanatliq që shërbenin në ushtri), ose ishin në mesin e popullatës që shpëronin pushtimet. Disa nga këta romë shkuan së bashku me ushtrinë në Evropë, por një numër i konsiderueshëm qëndruan në Ballkan.

Ata figurojnë në dokumente të ndryshme zyrtare të qeverisë Otomane dhe administratën lokale, kryesisht në regjistrat e detajuar të taksave, si dhe në një numër të urdhëresave gjyqësore lidhur me një varg të çështjeve (civile, ekonomike, religjioze dhe familjare). Sistemi social, politik dhe ekonomik i otomanëve ishte shumë i ndërlikuar dhe ngërthente një strukturë ushtarakisht administrative, ekonomike dhe religjioze. Ky sistem i komplikuar përfshinte tërë popullsinë dhe në mënyrë të rreptë

kontrollonte jetën e tyre ditore. Banorët gjithashtu ishin të klasifikuar në mënyrë hierarkike në kategori të ndryshme, ku dy më kryesorët ishin “besimtarët e vërtetë” (Myslimanët) dhe “të pabesët” (popullata e nënshtruar e krishterë). Këto kategori janë trajtuar ndryshëm, ku anëtari i secilës kategori kishte një status të ndryshëm dhe obligime të ndryshueshme ndaj shtetit qendror.

“CIGANËT” NË REGJISTRAT E TAKSAVE

Të gjitha subjektet e Perandorisë Otomane ishin të obliguar të paguajnë taksat të ndryshme dhe ishin përshkruar në regjistrat të shumtë të taksave. Dokumentet ekzistuese otomane pasqyrojnë hollësisht dëshirën e administratës të inkorporojnë popullatën “Cigane” në regjistrat e saj që ata të paguanin taksat e nevojshme. “Ciganët” ishin përshkruar tërësisht për kah moshën, profesionin, dhe statusin familjar, dhe sipas këtyre dhe faktorëve tjerë, ishin të grupuar në njësi të taksave (“jemaats”), ku secila kishte udhëheqësin e caktuar; në anën tjetër komunitetet ishin të ndara në njësi më të vogla, të bazuar në lagjen e romëve në secilin fshat ose qytet. Secili nga

këto njësi kishte udhëheqësin e saj, që nënkuptonte se këtu aplikoheshin principi i përgjegjësisë së kufizuar të grupit.

Përmendja e parë e “Ciganëve” në dokumentimin e taksave të Perandorisë Otomane daton nga viti 1430 dhe gjendet në Regjistrin e Timars (një lloj i pronës tokësore) për Nikopol “sanjak” (njësi territoriale), në të cilën 431 shtëpi të “Ciganëve” janë regjistruar, 3.5% të gjithë të regjistruarve. Nga ky regjistër i parë dhe nga dokumentet e vonshme historike bëhet e qartë se shumica e “Ciganëve” atje ishin vendosur dhe ishin dalluar sipas etnisë së tyre, dhe jo nga mënyra e jetës së tyre.

Në shumë raste “Ciganët” ishin përfshirë në regjistrat e përbashkët të taksave të njësitëve të caktuara territoriale, për shembull në rrethimin e ligjeve dhe rregullave lidhur me popullin e Provincës së Rumelias (përfshirë gati tërë siujdhesën Ballkanike) nga viti 1475 gjatë kohës së Mehmet II Fatih (Push-tuesi). Gjithashtu është ruajtur regjistri special, lidhur vetëm me “Ciganët”, siç ishin regjistrat e taksave për “Ciganët” e krishterë, që paguanin “jizie” (një taksë votimi për jo-myslimanët) prej vitit 1487-1489. Në të njëjtin regjistër 3,237 shtëpi “Cigane” plus edhe 211 shtëpi të vejushave. Regjistri në fjalë ka një rre-



III. 3
Dekreti i Sulltan Selimit II ë vitin 1574
(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 33) (Detaj)

Sipas dekretit të Sulltan Selimit II:

“Komunitetet cigane që ndodhen në Bosnjë janë krejtësisht të lirë nga taksat personale (m’af), nga taksat tjera të përkohshme (takalif-i yorfiye), dhe nga ndonjë taksë shtesë (avariz). Për Ciganët e lartpërmendur, një nga ata duhet të zgjidhen dhe emërohen për secilin grup prej 50 vetave të jetë udhëheqës (jemaat bashi). Askush nuk duhet të ndërhyrë në çështjet e tij, apo ta kufizoj atë në ndonjë mënyrë. Nëse ndokush shkel ligjin, ata duhet të paraburgosen dhe, po që se garancitë jepen nga komuniteti, dhe nga lideri, duhet të bëhet një dëgjim gojor.”

III. 4 (shkurtuar nga Marushiakova / Popov 2001, f. 34)

gullim të bashkëngjitur special të datuar nga viti 1491 i cili pasqyrore obligimet e taksave të votimit, dhe gjithashtu taksimin e specifikuar, p.sh. “ispence” (një taksë e pronës për të krishterët, që do të thotë “Ciganët” e vendosur). Të dhënat për numrin e madh të “Ciganëve” të vendosur të krishterë tregojnë se ata ishin vendosur në këto toka para pushtimit otoman, kur religjioni predominues ishte Krishteriyimi. Duke gjykuar nga regjionet e përmendura, “Ciganët” e krishterë si duket predominuan në regjionin e Tracit (që afërsisht korrespondon me pjesën evropiane të Turqisë moderne).

LIGJI LIDHUR ME “CIGANËT” NË PROVINCËN E RUMELIAS

Sulltani Suleiman i Madhërishti i cili qeverisi perandorinë gjatë triumfit të saj (1520-1566) kishte nxjerrë një “Ligj special lidhur me Ciganët në Provincën e Rumelia” në vitin 1530. Ky ligj na ndihmon që më mirë të kuptojmë informatën e mbledhur nga regjistruerit e taksave. [III. 2]

Rregullat e përfshira në ligj demonstronjë edhe një herë vendin e posaçëm të romëve në raport me dy kategoritë kryesore të Perandorisë

Otomane – “besimtarët e vërtetë” dhe “të pabesët”. Të gjithë “Ciganët”, pa marrë parasysh nëse ata ishin të krishterë ose myslimanë, paguanin taksën e votimit, e cila ishte mbledhur vetëm nga jo myslimanët. “Ciganët” e krishterë duhet të paguanin taksa paksa më të larta sesa myslimanët, por mospërputhjet në taksa në mes të kategorive të ndryshme të “Ciganëve” nuk ishin përvijuar në mënyrë të qartë dhe koherente. Një përjashtim ishte bërë për ata “Ciganët” të cilët ishin përfshirë në të ashtuquajturin “Sanxhak të Ciganëve”, përfshirë ata të përfshirë në ofrimin e shërbimeve ushtresë— për shembull “Ciganët” të cilët jetonin në fortesa dhe i mirëmbanin ato, farkëtarët që prodhonin ose riparonin lloje të ndryshme të armëve, muzikantët ushtarak dhe trupat e tjerë ndihmës. [III. 5]

Përveç kësaj, ky ligj zbulon ambicien e administratës otomane për tu siguruar që taksat të mbledheshin në tërësi nga të gjithë, përfshirë “Ciganët” shëtitës. Në këtë aspekt, tendenca e qartë për të inkurajuar anëtarët e komunitetit “Ciganë” për tu bërë përgjegjës për mbledhjen e taksave si garantues për pagimin e tyre me kohë, meriton një vëmendje të posaçme. Në të njëjtën kohë, përgjegjësia për ndonjë mos pagesë të mundshme

të obligimeve ndaj autoriteteve ishte në duart e këtyre anëtarëve të komunitetit “Ciganë”. Kjo vërtetohet me dëshminë e mëtejme, për shembull një dekret nga Sulltan Selim II në vitin 1574, që i obligonte minatorët “Ciganë” nga Banja Luka, i cili kishte një status special, të formonin grupe prej pesëdhjetë vetave, ku secili grup zgjidhte udhëheqësin i cili ishte përgjegjës ndaj autoriteteve. [Iills. 3, 4]

“SANXHAKU I CIGANËVE” – ROMËT NË USHTRINË OTOMANE

“Ligji lidhur me Ciganët në Provincën e Rumelia” vërteton statusin special ligjor administrativ dhe të drejtat e gjëra për taksimin vetë-qeverisës për ata që jetonin në “Sanxhakun e Ciganëve”. Prej vitit 1541, gjithashtu ekzistonte edhe një ligj special lidhur me udhëheqësin e “Sanxhakut të Ciganëve”. Ky institucion kishte prejardhjen nga Anatolia por ishte modifikuar për t’iu përshtatur “Ciganëve” në Ballkan. Në këtë rast “sanxhaku” nuk përdoret në kuptimin e zakonshëm të njësisë territoriale por në kuptimin e kategorisë speciale të popullsisë “Cigane” e cila ishte e përfshirë në një



III. 5

Ushtria otomane me (romët me gjasë) muzikantët e ushtrisë para portës së Budas dhe Pestit.

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 21)



III. 6

Përshtypja dhe nuanca e vulës së kuqe të Karnelisë, të llojit i cili është përdorur nga autoritetet otomane për të deklaruar se taksat janë paguar në mënyrë të duhur.

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 40)

numër të aktiviteteve ndihmëse në shërbim të ushtrisë.

Sidoqoftë, romët gjithashtu u rekrutuan edhe në ushtri. Ekzistojnë dëshmi nga viti 1566, se disa anëtarë të popullatës së taksuar të cilët ishin thirrur për detyra ushtarake ishin romët mysliman. Vlerësimet e bazuara në të dhënat e ruajtura tregojnë se gjatë shekujve 16-të dhe 17-të në mes të 15,000 dhe 20,000 “Ciganë” duhet të kenë qenë të përfshirë në ushtrinë Otomane duke ndërmarrë shërbime të ndryshme, kryesisht detyra ndihmëse ushtarake.

“SANXHAKU I CIGANËVE” – ROMËT NË SHËRBIMET NDIHMËSE TË USHTRISË

“Ciganët” e përfshirë në “Sanxhakun e Ciganëve” ishin grupuar në “myusellem” (togje) dhe njësi të tyre ndihmëse. Në krye të secilit “myusyulem” ishte “mir-liva” (majori), që nuk ishte “Cigan”, dhe i cili ishte përgjegjës për katër kapiten dhe njëmbëdhjetë te-

tarë. Për shërbimet e tyre “myusellem” (gjithsej 543) merrnin prona tokësore, gjithsej 449, të vendosura në 17 regjione të Rumelias. Anëtarët e “myusellem” ndërmorrën detyra ndihmëse ushtarake. Kreu i „Sanxhakut të Ciganëve” kishte bazën në qytetin e Kırk Klise (Kırklareli modern) në Thrace lindore.

REGJISTRI I TAKSAVE I SULLTAN SULEIMAN I I MADHËRISHMI

1522-1523, gjatë sundimit të Sulltan Suleiman I të Madhërishtmit, edhe një regjistër tjetër i taksave ishte përgatitur, i quajtur “Lista gjithëpërfshirëse e të hyrave dhe taksimit të Ciganëve të Provincës Rumelia”. Ky regjistër i gjerë përbëhej nga 347 faqe dhe në mënyrë specifike trajtonte “Ciganët”. Në të regjistrohej numri i shtëpive të “Ciganëve” të klasifikuara sipas komuniteteve të taksave, që gjendeshin në nëntë regjione gjyqësore duke përfshirë pjesët e mëdha të asaj që sot është siujdhesa

Ballkanike. Ky është një dokument unik me një sasi të madhe të të dhënave për popullsinë “Cigane” në Ballkan në fillim të shekullit 16.

Në regjistër ishin regjistruar 10,294 shtëpi të “Ciganëve” të krishterë dhe 4,203 shtëpi të “Ciganëve” mysliman (në total ishin përfshirë edhe 471 shtëpi të vejushave). Përveç këtyre, ishin edhe 2,694 shtëpi myslimane në “Sanxhakun e ciganëve”. Sipas llogaritjeve të njëjta, duke numëruar secilën shtëpi me një mesatare prej 5 anëtarëve, kjo arrinte gjithsej 66,000 “Ciganë” në Ballkan, prej të cilëve diku 47,000 ishin të krishterë.

Llogaritjet e mëtejme të bëra në bazë të këtij regjistri janë gjithashtu të njëjti interes të madh. Sipas këtyre llogaritjeve, gjithsej 17,191 shtëpi të “Ciganëve” – që u bë territori i shteteve të tanishme në Ballkan – ishin shpërndarë si në vijim: Turqi – 3,185, Greqi – 2,512, Shqipëri – 374, ish Jugosllavi – 4,382 dhe Bullgari 5,701, ndërsa lokacioni i saktë i 1,037 shtëpive nuk është i sigurt. Regjistrat e taksave Otomane gjithashtu shërbejnë si burim për kuptimin e konfesioneve fetare

بنك = ۱ دوی = ۲ ترك = ۳ استاز [۴] = ۴ پنج = ۵
شو = ۶ افق = ۷ اوختو = ۸ نكه = ۹ دش [۱۰] = ۱۰ (فراهون)
اسم انهدر یعنی حشاشه حشاشه یرتکریسی فرعون اوله یرقومی [۱۱] آکه فراهون دیرلر.
(همدنون) نو پینمبر. (زبان [۱۲] هون) وئو پادشاهدیر. (دلکه هون) اونوقری
پادشاهی. کلوشه هون اولو اولیالیر. (میساهون) موسی پینمبر. (هرون هون) هارون پینمبر.
(مصاب هون) بابا پینمبر. (مترو) اکک. (بانکی) سو. (ماش) ات. (دودوه) قباق. (شاش) حشا.
(مانجیان [۱۳] جانس) کوزل بطلیجان. (کران) پینر. (سسه) انجیر. (موکرز
صوبی [۱۴] کنکان) نشلرسن نه صاندک. (شوقرتوسوکرز) این خوش باسن نشلرسن.
(اتی قی [۱۵] کرز) اشته اشلی بورز. (نولی [۱۶] کرز) نه اشلرسن. (اورداپار
دا کرز) اوقاق دفک اشلی بورز. (جابکن) وار سات. (صوبی کنکان) [۱۷]
نه صاندک. (بول بکن کوم) ابدیه کوت صاندم. (قاصته دیان) کیمه کوت ویردک.
(بنقال بله دیوم) بر کافره کوت ویردم. (داووکس [۱۸] کره دایا پوبه) بن سکیم
بنوک اناسی.

III. 7
Fjalët e shkruar në gjuhën Romani nga Evlia Çelebi në emrin Sheyhat, 1668.
(nga Marushiakova / Popov 2001, f.43) (Detaj)

Udhëtari Evlia Çelebi kishte rastin të shfrytëzonte listën e gidave të zejtarëve (“sinifs”) në Stamboll. Kjo listë përmbante pesëdhjetë e shtatë gida, ku “Ciganët” për herë të parë janë përmendur në gidën e 10-të, ajo e shumëzimit të arinjve, që përbëhej nga gjithsej shtatëdhjetë njerëz. Në gidën e 15-të gjendeshin tregtarët e kuajve (“jambazes”) të përbërë nga 300 njerëz, dhe si Evlia Çelebi shkruante: “Tregtarët e kuajve janë tregtarë të pasur, ku secili prej tyre kanë stalla prej 40-50 kuaj Arab; shumica e tyre janë Ciganë edhe pse janë disa që u përkasin njerëzve të tjerë.” Gida e 43-të, ajo e muzikantëve, përbëhej nga 300 njerëz, ku gjithashtu shumica ishin “Ciganë”.

III. 8
(nga Marushiakova / Popov 2001, f.44)

të romëve. Në përgjithësi, duke përmbledhur të dhënat në dispozicion nga regjistrat e taksave, mund të thuhet se romët e krishterë mbizotëronin në shekujt 15-të dhe 16-të.

MASAT KUNDËR NOMADIZMIT. VENDOSJA E “CIGANËVE”

Një pjesë e romëve në Perandorinë Otomane jetonin një jetë nomade, që krijonte probleme për administratën shtetërore. Për këtë arsye ligjet dhe rregulloret parashikonin ndëshkime për “Ciganët” mysliman të cilët “bridhnin” (që do të thotë jetonin një jetë nomade) pranë “Ciganëve” jo mysliman.

Arsyeja e kësaj politike bëhet e qartë nga pjesa më e herët e cituar e “Ligjit lidhur me Ciganët në Provincën e Rumelias” të lëshuar nga Suleiman I i Madhërishtmi, që shpjegon se problemi nuk ishte aq shumë lidhja e “Ciganëve” mysliman me ata jo-myslman, por fakti se, kur udhëtonin ata nuk paguanin taksat e tyre rregullisht. Sidoqoftë, është

shumë e rëndësishme, që nuk kishte një përvijim të qartë se kush duhej të shqiptonte masat kufizuese ndaj “Ciganëve” (dhe si); kjo tregon se, për ndonjë arsye, autoritetet Otomane nuk iu kushtonin shumë rëndësi këtyre çështjeve (nomadizmin, dhe pagesat e parregullta të taksave).

Zakonisht komuniteti kryesor i taksimit (“jemaat”) në Perandorinë Otomane ishte i lidhur me një njësi të posaçme territoriale, edhe atëherë kur kjo përfshinte “Ciganët” nomad, pasi që nuk kishte dallime në obligimet e taksave të “Ciganëve” sipas mënyrës së tyre të jetesës (të vendosur ose nomad). Regjistri i viteve 1522-1523 tregon për vetëm njëmbëdhjetë grupe nomade të regjistruara për qëllime të taksave në disa fshatra. Kjo vështrëse pasqyron situatën reale. Është e mundur që njerëzit shëtitës shpesh ishin regjistruar si popullatë e vendosur, por në realitet ata vazhdonin mënyrat e tyre nomade (kryesisht stinore) të jetesës.

Dokumentet Otomane pasqyrojnë dëshirën e administratës për të sh-

tyrë “Ciganët” nomad të vendosen ose së paku të kufizojnë territorin e tyre të nomadizmit. Kjo mund të shihet në një rregullore e Sulltan Suleiman I të Madhërishtmi nga viti 1551, i përsëritur gati fjalë për fjalë nga Sulltani Murad III në vitin 1574. Sidoqoftë, është e evidente se këto masa dhe me gjasë edhe masat tjera administrative ishin të pasuksesshme. Në praktikë, duket se për autoritetet nomadizmi nuk ishte një problem serioz.

Në qytezat dhe fshatrat e Ballkanit romët e vendosur jetonin në lagje të izoluara të “Ciganëve” (“mëhalla”) – një parim themelor i vendosjes për të gjitha komunitetet minoritare në Perandorinë Otomane. Numri i romëve të vendosur ishte i madhe. Një përshtypje e ngjashme ishte regjistruar në Anatoli në fillim të shekullit të 17-të nga udhëtari i njohur otoman Evlia Çelebi (1611-1679). Ai vërejtë se shumica e “Ciganëve” që jetonin atje ishin të vendosur. [Illi. 7-8]

Regjistrat e taksave pasqyrojnë vendosjen e përhershme si dhe një shkallë të caktuar të pasurisë në mesin e “Ciganëve”. Ky lloj i informatës, për

Si fitonin romët për jetën e tyre

Rënia e perandorisë otomane

Statusi civil i “ciganëve”. Legjislacioni zyrtar dhe realiteti i përditshëm

Fillimi i emancipimit të romëve



III. 9

Afërsisht i lidhur me artin e muzikantëve “Ciganëve” ishte zhvillimi i disa formave të specializuara të performancave teatrale muzikore, për shembull, teatri i kukullave.

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 66)

Në regjistrin e taksave të vitit 1522-1523, në mesin e profesioneve të regjistruara të “Ciganëve”, janë muzikantë, teneqexhi, nallban, arpunues, krijues shpatash, krijues stufash, këpuctar, krijues sandalesh, krijues gozh-dësh, punëtor lëkurash, rrobaqepës, krijues tepihësh, ngjyrues, tregtar hekurishesh, prodhues djathi, kasap, qebapxhi, oborrtar, muskharë, truprojë, roja burgu, shërbëtorë, korrier, mbajtës majmunësh, gërmues pusesh dhe të tjerët, herë pas here përfshirë oficerët e ushtrisë, jeniçerë, policë, doktorë, kirurgë dhe murgj.

III. 10

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 44)

shembull, mbahet në procedimet gjyqësore të regjionit të Sofias që nga fillimi i shekullit të 17-të. Të renditura në mesin e taksave të paguara nga “Ciganët” ishin taksa mbi shitjen e shtëpisë, të vënë në 20 shtëpi, si dhe taksa mbi delet. Për më tepër, ekzistojnë dëshmi të mëtejme të “Ciganëve” relativisht të pasur: në vitin 1611 “Cigani Stefan” kishte shitur shtëpinë e tij në Sofi si dhe dyqanin e tij dhe disa drunjtë frutash për 2,400 akshe (një shumë goxha e rëndësishme, marrë parasysh shumën e zakonshme të taksave vjetore për një shtëpi “Cigane”, e që ishte diku 25 akshe).

SI FITONIN ROMËT PËR JETËN E TYRE

Romët në Perandorinë Otomane punonin në një varg të profesioneve. Në regjistrin e taksave të viteve 1522-1523 “Ciganët” më së shpeshti u regjistronin si muzikantë (ushtarak ose të pavarur), që gjithashtu vërtetohet nga burime tjera. Instrumentet muzikore më së shpeshti të përmendura ishin “zurna” (një lloj i oboas) dhe daullet, por edhe instrumentet tjera janë përdorur gjithashtu (më së

shpeshti dajrja dhe kohëve të fundit instrumentet e ndryshme me tela). Përveç kësaj, ekzistojnë dëshmi të shumta për ansamblet e “Ciganëve” me vallëzues (kryesisht romët dhe nganjëherë gratë çifute).

Në shumë vende rreth botës romët janë të njohur si farkëtar. Ky zana ka një traditë të gjatë, dhe është ruajtur mirë në Ballkan deri në ditët e sotme. Edhe pse gjatë periudhave të caktuara kohore— siç është fillimi i shekulli të 16-të – farkëtarët dhe tregtarët e hekurishteve romë ishin relativisht të rrallë në Perandorinë Otomane, dëshmitë për farkëtarët bëhen të gjëra nga shekulli i 17-të e tutje. [Ils. 9, 10]

Në disa raste romët braktisnin profesionet e tyre të mëparshme dhe përfshiheshin në bujqësi, të cilën e praktikuan brenda kornizës së pronave ekzistuese feudale të oficerëve ushtarak. Për shembull, në një inventar të çifligjeve në regjionin e Sofisë, të viteve 1445-1446, ekzistojnë informata të hollësishme për një çiflig pronë e Aliut, e cila përfshinte fshatin e Dabijivit; ai përbante 15 shtëpi të plota dhe 3 shtëpi të vejushave; inventari në mënyrë kategorike konstaton se “ata janë Ciganë”.

RËNIA E PERANDORISË OTOMANE

Pas epokës së fuqisë dhe lavdisë në shekujt 16-të dhe 17-të, Perandoria Otomane hyri në një periudhë të ngecjes dhe që nga fundi i shekullit të 17-të dhe fillimi i shekullit 18-të e më tej filloi periudha e gjatë e rënies graduale (por thelluese). Kjo periudhë (shekujt 18-të dhe 19-të) karakterizohej me krizë të përhershme që ndikonte në kushtet sociale dhe ekonomike si dhe me sistemin e ndërlikuar administrativ, dhe ishte e shoqëruar me një rend të gjatë të luftërave të pasuksesshme dhe humbjes së territoreve. Për shkak të krizës gati të përhershme politike dhe ekonomike regjistrat e ndryshëm shtetëror (të taksimit, gjyqësor dhe të tjerët) gradualisht humbën rëndësinë e tyre. Prandaj, burimet historike për romët në perandori u bënë fragmentare dhe të pasigurta.


Gjatë kësaj periudhe kohore një ndryshim domethënës në përkatësinë fetare të romëve u bë e dukshme. Gjatë shekujve 15-të dhe 16-të romët e krishterë mbizotëronin, ndërsa gjatë she-

ROMËT E KLASËS PUNËTORE

Në vitin 1836, bullgari Dobry Jeliaskov, i njohur si “Njeriu i Fabrikës”, ka hapur uzinën e parë moderne të tekstitit në Perandorinë Otomane në qytetin e Slivenit, për të bërë rroba për shtetin – kryesisht për ushtrinë otomane. Forca kryesore punëtore ishin romët nga qyteti i Slivenit, pasi që në atë kohë bullgarët ishin zejtarë, tregtarë, apo punonin në bujqësi, dhe të vetmit punëtorë të paangazhuar ishin romët (burrat, gratë, madje edhe fëmijët). Gradualisht, u krijua një klasë punëtore e përbërë nga familjet rome të përfshira në industrinë e tekstitit që u zhvillua në mënyrë të konsiderueshme pas çlirimit të Bullgarisë (1878) kur një numër i fabrikave të reja u hapën në Sliven që u bë një qendër e rëndësishme e industrisë së tekstitit.

III. 11

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 69)



III. 12

Uzina e Dobry Jeliaskov në Sliven, rreth vitit 1870.

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 69)

kullit të 19-të ekuilibri ishte ndërruar në mënyrë radikale dhe myslimanët ishin shumicë. Proporcioni i krishterëve me mysliman është llogaritur si 1:3 ose 1:4 në vlerësimet e ndryshme, por është e vështirë të sigurohen shifrat e sakta. Mund të përfundojmë se ekzistonte një trend i vazhdueshëm gjatë shekujve për tu konvertuar në Islam.

Autoritetet otomane vazhduan të ndërmerrnin masa administrative për të shtyrë “Ciganët” të vendoseshin përherë, por, sikurse me përpjekjet e mëhershme, në shumicën e rasteve këto përpjekje ishin të pasuksesshme. Sidoqoftë, prej fundit të shekullit të 18-të e tutje burimet zbulojnë një rritje të vendosjeve të përhershme të “Ciganëve” në fshatra dhe mbështetjen e tyre në bujqësi, një tendencë që për herë të parë u paraqit para disa shekujve në Perandorinë Otomane. Gjithashtu u paraqitën fshatrat e reja në lagjet e “çifligjeve” (fermave të mëdha), të cilat ishin të populluara tërësisht nga “Ciganët”, prej nga ata rekrutoheshin si punëtor të punësuar të bujqësisë.

Disa romë e gjetën veten në zeje krejtësisht të reja. Ky është rasti me “proletariatit e Ciganëve” që qytetin

e Slivenit (Bullgari). Në vitin 1836 ishte hapur uzina e parë moderne e tekstitit në Perandorinë Otomane, e cila prodhonte rroba për të përmbushur nevojat e ushtrisë otomane. Shumica e punëtorëve të punësuar në këtë uzinë ishin romë. [Iills. 11, 12]

STATUSI CIVIL I “CIGANËVE”. LEGJISLACIONI ZYRTAR DHE REALITETI I PËRDITSHËM

“Ciganët” zinin një vend të posaçëm në strukturën përgjithshme sociale dhe administrative të perandorisë. Në radhë të parë ata kishin qenë “Qytetarët” e perandorisë që nga krijimi i saj. Përkundër ndarjes së popullatës së perandorisë në dy kategori kryesore (“besimtarët e vërtetë” dhe “të pabesët”), ata kishin statutin e tyre specifik dhe dalloheshin në bazë të etnisë së tyre. Nuk kishte ndonjë dallim të fuqishëm në mes të “Ciganëve” mysliman dhe të krishterë, në mes të nomadëve dhe të vendosurve. Në tërësi, ata ishin afër popullatës lokale, me disa privilegje të vogla për “Ciganët” mysliman, dhe përfitime më të mëdha për ata që ishin në shërbim ushtarak.

Ky dallim etnik i “Ciganëve” nuk është i ndërlidhur me të ashtuquajturin “Sistemi Milliet”, siç shpesh mendohet gabimisht. “Sistemi Milliet” në kuptimin e dallimit të njerëzve të ndarë (në kuptimin etnik, jo religjioz) ishte paraqitur si një rrjedhim i përpjekjeve për reforma në Perandorinë Otomane nga shekulli i 19-të e tutje. Sidoqoftë, ndarja e “Ciganëve” ishte rrënjësore në ndjenjën e përgjithshme ndaj tyre: Shumë burime zbulojnë një përbuzje evidente e pjesës tjetër të popullsisë ndaj tyre— njëjtë si popullsia otomane dhe lokale— duke i konsideruar si njerëz inferior të cilët nuk meritonin ndonjë vëmendje, një stereotip social prej kohe, i cili ka mbijetuar në Ballkan deri më sot.

Përkundër këtyre qëndrimeve të vazhdueshme shoqërore, dhe ndoshta edhe për shkak të tyre, romët arritën të ruajnë – ose zhvillojnë – shumë karakteristika kulturore etnike nën sundimin Otoman, si për shembull një mënyrë (gjysmë) nomade të jetesës si dhe disa zanate tradicionale, dhe përfundimisht mbetën një komunitet etnik relativisht i mbyllur. Sidoqoftë, në tërësi, statusi civil i romëve në Perandorinë Otomane ishte më i favorshëm sesa i kushërive të

ROMËT SI LUFTËTARË PËR LIRI

Romët gjithashtu morën pjesë në luftërat për çlirimin kombëtar të popujve ballkanik. Romi Alija Plaviq dhe vëllai i tij Mujo (i cili vdiq në vitin 1807) morën pjesë në kryengritjet serbe kundër Perandorisë Otomane në fillim të shekullit të 19-të. Në nga “hajdutët” më të famshëm (luftëtarët për liri) në shekullin e 19-të ishte romi Mustafa Shibil (i lindur në fshatin Gradets, afër

Sliven, dhe i vvarë me 1856). Romët nga Sliveni (vëllëzërit Yordan dhe Georgy Hajikostovi, Yordan Ruschev) morën pjesë në luftën Turko-Ruse (1877-1878) në radhët e ushtrisë ruse si vullnetarë bullgar.

III. 13

(nga Marushiakova / Popov 2001, f. 70)

tyre në Evropën Perëndimore, ku, gjatë periudhës së njëjtë historike, romët ishin persekutuar.

FILLIMI I EMANCIPIIMIT TË ROMËVE

Në vitin 1866 Petko Rachev Slaveikov, një autor i famshëm bullgar, publikoi një artikull të nënshkruar nga “një Egjiptas” (“një Cigan”) në gazetën Gaida me bazë në Stamboll. Në këtë letër, autori, Ilija Naumchev nga qyteti

i Prilepit, mbron të kaluarën e lavdishme të “të drejtave të Ciganëve” për tu trajtuar barabartë, për të “pasur shoqërinë e tyre dhe kujdesur për arsimimin e tyre”, për të pasur “priftërinjtë Cigan” etj.

Letra në tërësi ilustron fillimin e një faze të re në zhvillimin e vetëdijes në mesin e së paku disa anëtarëve të komunitetit romë në Ballkan gjatë shekullit të 19-të. Për këtë fazë të re ishte tipike procesi i bërjes së kornizës së “brendshme të komunitetit tradicional në mënyrë që të kërkohej

një vend i barabartë në realitetin e ri “të jashtëm” shoqëror dhe kulturor. Atmosfera e përgjithshme në Ballkan në atë kohë paracaktoj formën e këtij aktiviteti të ri shoqëror. Sikurse pjesa tjetër e popullsisë në Ballkan (për të cilët shekulli i 19-të është shekulli i nacionalizmit modern) romët, gjithashtu, në mënyrë aktive kërkonin të kaluarën e lavdishme si dhe krijimin e një mitologjie historike nacionale. Kjo ishte e nevojshme që ata të përkraheshin në përpjekjet e tyre për emancipim civil.

PËRFUNDIMI

Pas rënies së Perandorisë Otomane romët qëndruan përherë brenda kufijve të rinj të shteteve një-kombëtare të Ballkanit. Që nga atëherë e tutje, fati i tyre historik dhe evolucioni i

tyre si komunitete është ndërthurur me ato të popullsisë tjera shumicë të këtyre vendeve. Sidoqoftë, trashëgimia e Perandorisë Otomane mbetet e pranishme në mënyra të ndryshme – ose në formë të kulturave të vendosura etnike siç është Islami dhe

zakoneve dhe traditave përkatëse të trashëguara nga një numër i madh i romëve në Ballkan, ose në formë të ndikimit që traditat kulturore dhe historike otomane ende kanë në jetë në shtetet e veçuara ballkanike.

Bibliografia

Crowe, David M. (1995) *A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia*. London / New York: I. B. Tauris Publishers | **Fraser, Angus (1992)** *The Gypsies*. Oxford / Cambridge: Blackwell | **Gilsenbach, Reimar (1994)** *Weltchronik der Zigeuner. Teil 1: Von den Anfängen bis 1599*. Frankfurt am Main: Peter Lang | **Gronemeyer, Reimer / Rakelmann, Georgia A. (1988)** *Die Zigeuner. Reisende in Europa*. Köln: DuMont Buchverlag | **Inalçik, Halil (1997)** *An Economic and Social History of the Ottoman Empire, Volume 1*. Cambridge: Cambridge University Press | **Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (2001)** *Gypsies in the Ottoman Empire. A contribution to the history of the Balkans*. Hatfield: University of Hertfordshire Press | **Todorov, Nikolaj (1972)** *Balkanskiat grad XV – XIX vek. Socialno-ikonomichesko i demografsko razvitie. [The Balkan town: social, historical and demographic development]*. Sofia: Bulgarian Academy of Sciences